

VENDIM

Nr. 818, datë 28.11.2016

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PUNËSIM DHE AFTËSI 2014 – 2020 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, dhe të neneve 22 e 23, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama